



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 04.06.2024

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“TURISTIK RESORT RED SOL”, ME HOTEL 1,2,3,4,5 KATE MBI TOKË, ME 2 KATE
NËNTOKË, VILA 1,2,3 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË DHE APARTAMENTE
ME 1,3,4,5,6 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË
DHËRMI, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Drymades Gallery” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: ““Turistik Resort Red Sol”, me hotel 1, 2, 3, 4, 5 kate mbi tokë, me 2 kate nëntokë, vila 1,2,3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë dhe apartamente me 1, 3, 4, 5, 6 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Drymades Gallery” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 05/12/2025